

PROCESVERBAL
nga vazhdimi i parë i seancës së tetë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 25.8.2025

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: Petar Xhurovski.

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Punonjësit nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunović, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi vazhdimin e parë të seancës së tetë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 11:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Z. Stefanovski informoj se në seancën e sotme do të shqyrtohet pika që më parë ishte shtyrë për arsye teknike, përkatësisht për shkak të një oferte të paraqitur në mënyrë të paqartë nga operatori ekonomik.

Z. Trajčevski shpjegoi se në materialin e sotëm oferta është definuar qartë. Operatori ekonomik paraqiti ofertë të re në të cilën janë renditur saktësisht mjetet për furnizim.

Udhëheqësi i Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit të Agjencisë – shef kabineti, mr. Dragica Ljubevska, shpjegoi se gabimi teknik është korrigjuar. Agjencia kontaktoi kompaninë që fillimisht paraqiti ofertë të paplotë dhe të paqartë, pas së cilës kompania paraqiti ofertë të re, ofertë të rishikuar. Pas kontrollit të kryer nga shërbimi profesional, u konstatua se oferta e re është teknikisht e saktë dhe është përfshirë në materialin për shqyrtim të pikës..

Znj. Vërzivolli konfirmoi se e kishte shqyrtuar ofertën dhe materialin dhe ishte e pajtimit se teknikisht është e saktë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që drejtori i Agjencisë të marrë vendim për furnizimin e shërbimit – informimit të publikut për Kodeksin e Sjelljes në hapësirën online gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve, me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik, në shumën prej 59.000,00 denarë pa TVSH.

Për zbatimin e shërbimit të lartpërmendur, mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,**

Mr. Sasho Stefanovski